

**Fjalimi i ministrit të Mbrojtjes, Vllado Misajlovski, në Ditën e Mysafirëve të Lartë të stërvitjes
“SHKËLQIMI 26”
PU “Krivollak” • 27 prill, 2026**

E nderuara Presidente Siljanovska-Davkova,
I nderuari shef i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral-major Lafçiski,
I nderuari përfaqësues nga JFC Naples,
Të nderuar miq, të nderuar gjeneralë,
Të nderuar kolegë të mi,
Të nderuar kryetarë komunash,
Të nderuar deputetë,
Të dashur mysafirë, ju falënderoj që keni ardhur,

Natyrisht, një falënderim i madh dhe me një duartrokitje të madhe t’i përshëndesim këta njerëz të mrekullueshëm dhe të gjithë ata që morën pjesë këto ditë. Çdo nder! Është krenari të jesh ministër i një Ushtrie të tillë! Shef, gjeneralë, çdo nder! Vërtet jeni krenaria e shtetit!

Sot, këtu në poligonin ushtarak “Krivollak”, poligoni ynë më i madh për stërvitje dhe një nga kapacitetet për të cilat njihemi në Aleancë, të gjithë ne ishim dëshmitarë jo vetëm të demonstrimit të aftësive, por edhe të disiplinës, saktësisë dhe profesionalizmit të vërtetë. Ishim dëshmitarë të asaj që ne si udhëheqësi e themi vazhdimisht – se ushtarët tanë maqedonas punojnë sipas standardeve më të larta të NATO-s, duke treguar se përsosmëria e tyre nuk është një qëllim që duhet arritur, por është realitet.

Procesi i vlerësimit të NATO-s, që zgjati gjatë muajit prill, dëshmoi një të vërtetë të madhe – se pjesëtarët e Grupit të Batalionit të Lehtë Këmbësorik dhe të gjitha njësitë e tjera që shërbyen si mbështetje në kuadër të vlerësimit janë “të aftë për realizimin e misionit”, përkatësisht luftarakisht të aftë. Një vlerësim për të cilin asnjëherë nuk pata dyshim se nuk do ta merrnin.

Nga kjo foltore u drejtoj urime çdo ushtari maqedonas dhe të gjithë të përfshirëve për suksesin më të madh të arritur deri më tani.

Vlerësimi im që nga fillimi u bazua në dy aspekte kyçe.

I pari është profesionalizmi i ushtarëve maqedonas, në të cilin besoj fuqishëm. Është evidente motivimi dhe përkushtimi i tyre për të qenë më të mirët, për të qenë garantues të sigurisë së atdheut, si dhe gatishmëria dhe aftësia që tregojnë në vend dhe në kuadër të Aleancës.

I dyti është procesi i modernizimit, i cili na mundësoi edhe në këtë stërvitje të shohim kapacitetet e reja të forcuara të Ushtrisë. Investojmë shumë – në armatim të ri personal, në kapacitete të reja dhe të avancuara, në mbrojtje të fuqishme kibernetike, në automjete të reja të blinduara, makina inxhinierike, mjete ajrore pa pilot etj. Për të gjitha këto kemi plan të cilin e ndjekim me përpikëri dhe kemi mbështetje të fuqishme edhe nga Presidentja, edhe nga Qeveria, për çka u jam pafundësisht mirënjohës. Mbështetja e tyre na mundësoi rritje të qëndrueshme të buxhetit të mbrojtjes dhe investime serioze në pajisje të reja dhe të sofistikuara që arrijnë në 32.5 për qind të buxhetit të ministrisë.

U drejtoj urime të gjithë pjesëtarëve të Armatës të përfshirë në organizimin dhe realizimin e kësaj stërvitjeje. Vërtet një detyrë komplekse duke pasur parasysh se mbi 1.500 pjesëtarë të Armatës punuan

në një skenar fiktiv me 25 ngjarje dhe mbi 100 incidente. Përkushtimi juaj ishte i dukshëm edhe sot dhe gjatë realizimit të stërvitjes që përfundon me sukses të plotë.

Konfirmimi për këtë sukses më të madh vjen pikërisht nga ekipi monitorues i NATO-s, i cili vulosi raportin final të vlerësimit, të realizuar sipas 799 kritereve, me standardet më të larta të NATO-s.

Të nderuar të pranishëm,

armata maqedonase po bën hap historik përpara sa i përket kapaciteteve të saj. Operojmë me pajisje të reja, të sofistikuara, si çdo ushtri tjetër e NATO-s. Pjesëtarët tanë janë në të njëjtin nivel me të tjerët nga Aleanca. Kemi interoperabilitet të plotë, që na mundëson së bashku të mbrojmë atë që për ne është më e shenjta – lirinë, atdheun, demokracinë. Të mbrojmë vlerat tona që janë të rrënjësura në shoqërinë maqedonase.

Në kohë ndryshimesh serioze gjeopolitike dhe paqëndrueshmërie, të kesh një Armatë që është e aftë të jetë garantuese e sigurisë së shtetit dhe njëkohësisht e aftë të veprojë si një me ushtritë e vendeve aleate, është nder dhe kënaqësi!

Nga kjo foltore do të dërgoj edhe një mesazh tjetër – se nuk ndalemi këtu. Vazhdojmë me investimet e fuqishme në Armatë, sepse siguria për ne është mbi të gjitha. Ajo është themeli i zhvillimit shoqëror dhe ekonomik. Vazhdojmë me furnizimet me pajisje të reja, vazhdojmë me trajnimet dhe stërvitjet dhe vazhdojmë me kujdesin për çdo pjesëtar të Armatës, sepse motivimi dhe përkushtimi i tyre janë përbërësit kyç për një Armatë të fortë.

Ju faleminderit të gjithëve!